



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.11.2022, ora 15:00

Drejton mbledhjen Sokol Binaj – Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

#### Rendi i Ditës:

*Vijimi i mbledhjes të datës 21.11.2022 në lidhje me vijimin e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjen e kandidatëve të lejuar për këtë vakancë, znj. Elsa Miha dhe znj. Holta Zaçaj si edhe me hapat e mëtejshëm për dërgimin e listës drejt Gjykatës së Lartë, si organ i emërtesës.*

#### Marrin pjesë:

- |                          |                      |
|--------------------------|----------------------|
| 1. Sokol Binaj           | (Kryetar)            |
| 2. Anila Leka            | (anëtare)            |
| 3. Edlira Petri          | (anëtare)            |
| 4. Klodiana Mema (Veizi) | (anëtare)            |
| 5. Genti Xholi           | (anëtar)             |
| 6. Sandër Simoni         | (anëtar zëvendësues) |

#### Marrin pjesë si vëzhgues të përhershëm:

1. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, Enio Haxhimihali

**HAPET MBLEDHJA: ora 15.00**

**Kryetari Sokol Binaj** – Atëherë e deklarojmë të hapur mbledhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të caktuar në datën e sotme, me rend dite paraqitjen e ekspertës e cila do të bëjë vlerësimin e njohurive të gjuhës së huaj në anglisht të kandidatëve zonja Semini dhe zoti Dvorani, si dhe realizimin e procedurës së betimit të ekspertës. Përpara se të kalojmë tek prezantimi i ekspertës marrjen e gjeneraliteteve të saj dhe procedurën e betimit.

Verifikohet prezenca e pjesëmarrësve;

Të pranishëm janë: Zonja Leka, zonja Petri, zonja Mema (Veizi), zoti Xholi, dhe Binaj.  
I pranishëm në mbledhje është përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, Enio Haxhimihali.  
Lidhur me vazhdimin e mbledhjes, jemi dakort të vazhdojmë, pasi kemi një kuorum minimal prej 5 anëtarësh ?

Anëtarët e pranishëm - Dakort

Pra, jemi në gjëndje të vazhdojmë procedurën e përcaktuar për ditën e sotme.

U thirr dhe u paraqit ekspertja zonja Etleva Kondi.

**Etleva Kondi** – e bija Luftarit dhe e Lules, dtl. 4 shkurt 1978, aktualisht punoj tek Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, rruga “Dervish Hima”, ap.14, pallati afër Ambasadës Amerikane, Tiranë.

**Sokol Binaj** – nga ana e këtij Këshilli, e këtij forumi të kësaj mbledhje, jeni ftuar me cilësinë për të realizuar detyrën e ekspertës për të vlerësuar njohurit e gjuhës së huaj të anglishtes, të sektorit tuaj, për të dy kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, vakancë e shpallur nga Kuvendi, znj. Semini dhe z. Dvorani, të cilët janë në pritje për të realizuar këtë ballafaqim me ju. Pra, detyra e ekspertimit është e thjeshtë mbi vlerësimin e njohurive të gjuhës angleze për dy kandidatët.

Në funksion të realizimit të procedurës së Betimit ju ftoj të bëni këtë deklaratë “ *i vetë dijshtëm për përgjegjësi morale dhe juridike për detyrën që marr përsipër. Do ta kryej atë me ndershmëri dhe me drejtësi*” – *Betohem*

**Etleva Kondi – Betohem**

**Sokol Binaj**- Faleminderit! Atëherë, mund të procedoni nëpërmjet sekretarisë.

**Ekspertja** – largohet

Mirë atëherë, duke qenë se e realizuam rendin e ditës për ditën e sotme deklaroj të mbyllur mbledhjen e caktuar.

Seanca e ardhshme sikurse e kemi caktuar në mbledhjen e djeshme është **data 30.11.2022 ora 13.00**

**Tiranë më datë 22.11.2022**

**KRYETAR**

**Sokol BINAJ**

